



ORGANISATION DU TRAITÉ DE L'ATLANTIQUE NORD  
NORTH ATLANTIC TREATY ORGANIZATION

13

LE SECRÉTAIRE GÉNÉRAL DÉLÉGUÉ  
THE DEPUTY SECRETARY GENERAL

SG/91/532

1st August 1991

Dear Ambassador,

I have the pleasure to inform you that the Alliance has decided to provide short, special courses at the NATO Defence College in Rome, Italy, and the NATO School in Oberammergau, Germany, for officers from all CSCE states.

The broad aim of these courses will be to promote greater awareness of NATO and how it is responding to the changing politico-military situation in Europe. With that in mind, each course will exist of a balanced mixture of lectures and informal discussions, thereby providing ample scope for a healthy exchange of views.

The Alliance is confident that this initiative will be seen by CSCE members as a further positive step along the road to greater openness, confidence and mutual understanding.

Practical details will be developed by the NATO Military Authorities and communicated to your Military Attaché.

I greatly hope that your Government will be able to respond favourably to this invitation.

Yours sincerely,

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Amedeo de Franchis".

Amedeo de Franchis  
Acting Secretary General

His Excellency  
Mr. Ksenofon Nushi  
Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary  
Embassy of the Republic of Albania  
Rue de la Pompe 131  
F - 75116 PARIS

MP

DREJTORIA E ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE  
DHE BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH

Informacion

Nga ambasada jone ne Rome njoftohemi se me daten 17-18 tetor 1991 zhvillohet ne Rome nje seminar me teme "Nato-ja ne udhekryq", organizuar nga Kolegji i mbrojtjes i NATO-s ne Rome. Diskutante te shquar do te trajtojne probleme te ristrukturimit e sigurimit evropian, ne kete periudhe ndryshimesh. Pritet te marrin pjese perfaquesues nga pothuajse te gjitha vendet e NATO-s dhe te KSBE-se. Eshte ftuar edhe nje perfaquesues nga vendi yne.

Me ndryshimin e klimes politike ne Evrope dhe te aleancave te meparshme ka ndryshuar edhe roli i NATO-s ne procesin e sigurimit evropian. Mendojme qe te marre pjese ambasadori yne ne Rome i cili me ane te nje materiali te shkurter alternativ te afirmoje edhe ndryshimin e politikes se Shqiperise ndaj kesaj aleance dhe rolit te saj aktual. Kjo edhe duke patur parasysh se kjo eshte ftesa e pare qe ky organizem i drejton Republikes se Shqiperise, ne rang te larte ambasadori, cka pasqyron se edhe politika e kesaj aleance ndaj vendit tone ka ndryshuar.

Tirane, me 11 tetor 1991

Q3.

*Debut z. Deshima  
Të pëftolli i deputit P. Kola  
metuesi i  
11.10.91*

*her me dat: 7. 11. 1991*

*J.ON*

*z Poullin*

21

TEZA MBI NJE PRERZANTIM TE MUNDSHEM TE PERFAQESUESIT

TONE NE SEMINARIN MBI NATO-n

(Rome, 17-18 tetor 1991)


- Pikesepari dua te falenderoj organizatorët e ketij seminari per ftesen per te marre pjesë ne kete shkembim mendimesh ne kete auditor te gjere. Shqiperia i dha fund edhe qendrimit te saj te paragjykuar ndaj Aleances se Atlantikut Verior dhe rolit te saj stabilizues te provuar tashme. Republika e Shqiperise qe me daljen nga Traktati i Varshaves, i eshte permbajtur parimit te qendrimit larg bloqeve. Kjo, megjithate, eshte pjesë e veteizolimit absurd dhe e shikimit te gjerave me skepticizem e paragjykime te llojeve te ndryshme. Koha, sidoforte, tregoi se kurre nuk mund t'i shmangesh kursit te historise.

- Ne kaleidoskopin e ri te zhvillimeve nderkombetare Republika e Shqiperise e konsideron Aleancen e Atlantikut Verior si ~~faktor te rëndësishëm~~ gur themeli te sigurimit evropian. Fundi i luftes se ftohte dhe i konfrontimit global kane krijuar mundesi dhe hapur mjaft opsione te reja. Ndryshimet e medha demokratike ne Evropen Qendrore e Lindore, prishja e Traktatit te Varshaves, dhe e ekuilibrave te tjere kane nxjerre ne plan te pare nje konceptim me te gjere te problemeve te sigurimit. Ne kete kuader edhe Aleanca e Atlantikut Verior po transformohet. Aftesia e saj per t'iu adaptuar ndryshimeve ne shkalle evropiane e boterore provon me se miri vitalitetin e saj. Ne mendojme se roli i saj si hallka kryesore lidhese midis Evropes dhe vendeve te Atlantikut Verior do te zgjerohet me tej ne sherbim te vendosjes se nje rendi me te gendrueshem te sigurimit ne Evrope e me gjere. Eshte tashme i provuar roli i saj ne sigurimin dhe mbrojtjen e vendeve anetare; por ne mendojme se ajo duhet te kontribuoje me shume ne nje kontekst me te gjere. Ceshtja nuk qendron thjesht ne vendosjen e partneriteteve te reja me vendet e Evropes Qendrore e Lindore pas transformimeve te tyre te thella demokratike, por krahas kesaj ne nje rikonceptim te rolit te saj politik teresor. E ne kete rikonceptim vendet e demokrative te reja padyshim qe do ta gjejne vendin e tyre. Ne kete kontekst i shikojme edhe ne

maredheniet tona me NATO-n. Marredheniet e vendosura me kete organizem ne akoma i kemi ne nje shkalle te ulet e, megjithate, interes i ekziston per t'i zgjeruar e shumefishuar.

- Institucionalizimi i forumeve te ndryshme evropiane, marrja persiper e detyrate te medha e te veshtira te bashkepunimit e sigurimit nga organizma panevropiane, nuk e minimizon aspak rolin e NATO-s. Bashkepunimi e kooperimi, vlera keto te pamohueshme te procesit te Helsinkit, duhet te shtrihen edhe ne maredheniet midis hallkave te ndryshme te sigurimit ne kontinent e me gjere. Ne kete drejtим NATO-ja ka shume eksperience te çmuar per t'u dhene organizmave te tilla si Qendra per Parandalimin e Konflikteve etj.

- Duke falenderuar edhe nje here per ftesen, e cila eshte shume domethenese per ne, shpreh besimin qe ky te jete vetem fillimi i nje procesi bashkepunimi midis Republikes se Shqiperise dhe kesaj organizate te pages.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "F. S. F.", is positioned below the final sentence of the text.

56

DREJTORIA E ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE  
DHE BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH

3627

AMBASADES ROME

Dorazi na ka ardhur nje broshure me dy flete bashkengjitur nga "NATO Defence College" per organizimin e nje kursi me teme:"Politikat e sigurimit te anetareve te aleances" me vendet e KSBE-se qe do te zhvillohet nga 21-25 tetor 1991 ne Rome. Nuk ka as ftese zyrtare dhe as sa vete duhet te marrin pjesa. Lutemi lidhuni me Sekretariatin, me zonjen Susan TURCHI ne numrin e telefonit:5923741 ext.243 dhe na njoftoni <sup>urgent</sup> sa me pare per te gjitha modalitetet.

MINJASHTME

Tirane, me 7 tetor 1991

*Z. Z. B. M.*

To the Land

7.X.91 1200'

(Y)

Nr. 48

Kabinet i Ministrat

top

Br II  
21. M. 91

Information

Siq eshte njoftuar, ne takimin e nivalit te larte te NATO-s te mbajtur ne Rome javen qe shkoi, udheheqesit e Aleances vendosen, midis te tjerash, krijimin e "Këshillit te Bashkepunimit". Ne kete organizem te ri bejne pjesa 16 anetaret e NATO-s, 6 anetaret e ish-Paktit te Varshaves dhe tri shtetet baltike qe porsa u shpallen te pavarura, pra 25 vende.

Keshilli i Bashkepunimit, perveç mbledhjeve te rregullta vjetore, do te kete edhe takime te jashtezakonshme te ministrave te jashtem dhe, po te jetet e nevojshme takime te ambasadoreve te NATO-s me koleget e tyre te Lindjes. Siç thuhet ne deklaraten perfundimtare te takimit te Romës, Këshilli i ri nuk ka per/ardhur ndesh me KSBE-ne. Ne takimet e tij ky organizem do te diskutoje, midis te tjerash, probleme te planifikimit te mbrojtjes, kthimin e industrise ushtareke ne industri civile, bashkepunimin shkencor etj.

Takimi i pare i Këshillit te Bashkepunimit do te mbahet me 20 dhjetor ne Bruksel. Nga burime zyrtare te NATO-s eshte theksuar se ne takimin e ardhshem te Këshillit te Bashkepunimit ne Bruksel te aprovohet nje deklarate politike e përbashket, per te shnuar keshtu fillimin e nje epoke te re partneriteti.

Vendi yne, Shqiperia, si dhe grupi i vendeve N+N (vendet neutrale e te paangazhuara) si Zvicra, Austria, Suedia, Vatikani, Finlanda, Jugosllavia, Qipro, Malta, mbeten jashtet këtij Këshilli. Jemi te mendimit se kjo situate ben te nevojshme ndermarrjen e veprimeve konkrete per te bere te mundur diskutime.

- 2 -

timin e pozicionit te Shqiperise dhe te raporteve qe ajo dëshiron te vendose me NATO-n. Për kete propozojme që nga ana e Ministrise se Puneve te Jashtme te behet një leter ku te shpjetohet pozicioni aktual i Shqiperise, deshira e saj per te marrë pjesë ne diskutimet per te ardhmen e raporteve ushtarakë ne Evrope dhe gjithashtu, te kerkohet marrja pjesë e perfaqesuesve te vendit tone ne mbledhjen e 20 dhjetorit ne Bruksel.

Tirane, me 15.11.1991

DREJTORIA E BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH  
DHE ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE

3. ON  
Gjelqje edhe z. V. Pule 111  
g. 23.11.91

I N F O R M A C I O N

Ne nje takim qe i ngarkuari me pune a.i. i RSH ne Vjene, z. Zef Mazi, pati me ambasadorin austriak, z. Vukovic, ky i fundit tha se ishin cuditur qe Deklarata e NATO-s e Samitit te Romes perjashtonte disa shtete, dhe se Shqiperia duhet te beje nje hap e te kerkoje te perfshihet ne takimin e ardhshem te Brukselit ne kuadrin e Keshillit te Bashkepunimit. Ai theksoi se, ne qofte se te tjeret ndodhen ne nje vakum sigurimi, Shqiperia ndodhet ne nje zone akoma me te pasigurte. Nga grupi N+N vetem qeveria e Suedise po ban nje levizje per pjesemarrje, por jo plotesisht te qarte. Ambasadori Vukovic tha se do te bisedonte me zevendesin e Vernerit qe ndodhet ne Vjene dhe do te jape sqarime te metejshme.

Nga ana e drejtorese z. Mazi u udhezua te ndjeke problemi pa u prononcuar per qendrimin tone. Jemi te mendimit se takime te tilla dypaleshe jane shume te domosdoshme per te njojur klimen e re brendq ketij organizmi. Perfaquesuesi yne ne Bruksel mund te bente takime jozyrtare me perfaquesuesit amerikane e gjermane per ta njojur me tej kete klime.

Tirane, me 22 nentor 1991

Gju

PZ

115

DREJTORIA E BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH

DHE ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE

9530

TEPER URGJENT

AMBASADES B R U K S E L

Z. Petraq Pojani

Mëmri kontakte jozyrtare me ambasadoret amerikane e gjermane prane NATO-s per te mesuar mendimin e tyre ne lighje me lenien.

e Shqiperise jashte Keshillit te Bashkepunimit si dhe mbi mundesite e pranise tone ne Mbledhjen e ketij Keshilli me 20 dhjetor, ne Bruksel. Beni sondazh mbi kete mbledhje, problemet qe do te trajtoje ajo, por mos u prononconi per qendrimin e Shqiperise. Njoftoni urgjentisht per zhvillimet.

Tirane, me 23 nentor 1991

MINJASHTME

Bulet

In the Brusels

23-XI-91

17<sup>30</sup>  
H

INFORMACION

NATO 119  
BVI 2

Me 20 dhjetor 1991 zhvillohet ne Bruksel Mbledhja e Nivelit te Larte te Anetareve te NATO-s ku do te shgyrtohet edhe bashkepunimi midis kesaj organizate dhe vendeve te Evropes Lindore e Qendrore.

Kjo mbledhje konsiderohet me rendesi te veçante sepse do te institucionalizoje bashkepunimin e ardhshem me NATO-n. Prandaj mendojme qe edhe vendi yne te beje perpjekje qe te dergoje aty nje delegacion me perfaqesues nga Ministria e Puneve te Jashtme dhe ajo e Mbrojtjes. Kjo pjesemarrje nuk eshte angazhuese per ne, por eshte e domosdoshme se pari si nje akt prezence i vendit tone ne kete forum dhe se dyti per te eksploruar mundesite konkrete te perfshirjes se Shqiperise ne bashkepunimin me NATO-n.

Lidhje shtetiale \* \* \* \* \*  
Shtetet ne  
perpjekje?

Persa i perkthet studimit per percaktimin e pozites se ardhshme te vendit tone ne raport me strukturat ushtaraket ekzistuese apo qe mund te krijohen mendojme qe te shkembehen mendime me perfaqesues te disa shteteve anetare te NATO-s apo neutrale. Per kete mund te shfrytezohej rasti i mbledhjes se 20 dhjetorit. Ne delegacionin tone te perfshihen shoket e grupit te punes. Gjate punimeve te gjejne mundesite per te biseduar me perfaqesues nga shtete te ndryshem, kurse pas mbarimit te saj te bejne nje ndalese te shkurter ne Suedi, Austri dhe Zvicer.

GRUPI I PUNES

Kostaq Karoli, Ksenofon Krisafi,  
Shaban Murati, Fiqiri Doda

Tirane, me 30.11.1991



120

DREJTORIA E BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH

DHE ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE

Informacion

GBH  
Te puthet se do te  
te ditur a fundit  
fund a fundit  
funden  
funden  
informacion

Ne lidhje me problemin e kerkeses per pjesemarrje te Shqiperise ne Mbledhjen e NATO-s te 20 dhjetorit ne Bruksel, Z. Petraq Pojani, i udhezuar per te marre kontakte jozyrtare me perfagesuesit amerikane e gjermane, ka takuar me 28.11.1991 zevendesperfagesuesin e Turqise ne NATO, Ministrin-keshilltar Z. Turhan Morali, i cili i beri te ditur te meposhtmen:

Ne Samitin e Romes U vendos qe ne kete mbledhje te ftohen "si hap i pare" ish-vendet e Traktatit te Varshaves. Italia dhe Turqia u perpojen qe te ftohet edhe Shqiperia, por kjo nuk u pranua per shkak te qendrimit te prere te SHBA-se (pavaresisht se ky qendrim nuk drejtohet kunder Shqiperise). Kanadaja dhe Franca ne parim u shprehen per nje rrith me te gjere te ftuarish. Mbledhja e 20 dhjetorit do te kete karakter inaugurues. Sipas Z. Morali eshte e veshtire qe te arrihet pjesemarrja e Shqiperise ne kete mbledhje, megjithate ai sugjeroi qe te tregohet sa me pare interes per marre pjese sepse kjo do te hapte rrugen per te ardhmen. Sipas tij kerkesa u duhet bese kryesisht SHBA-se Gjermanise, Italise e Frances.

Mendojme qe ne te bejme demarshet e duhura pasi te kemi mesuar gendrimin e SHBA-se dhe Gjermanise nga kontaktet jozyrtare qe do te marre Z. Pojani, sipas udhezimit qe i kemi derguar me daten 23.11.1991.

Tirane, me 30 nentor 1991

BB

Paulin Kola



No 113

NATO  
BRI 2

Z. Jll.

AA. 172  
10.12.91


Delend  
M

S h e n i m :

Me 20 dhjetor 1991 zhvillohet ne Bruksel Mbledhja e Nivelit te Larte te Anetareve te NATO-s ku do te shqyrtohet edhe bashkepunimi midis kesaj organizate dhe vendeve te Evropes Lindore e Qendrore.

Kjo mbledhje konsiderohet me rendesi te veçante sepse do te institucionalizoje bashkepunimin e ardhshem me NATO-n. Prandaj mendojme qe edhe vendi yne te beje perpjekje qe te dergoje aty nje delegacion me perfaqesues nga Ministria e Puneve te Jashtme dhe ajo e Mbrojtjes. Kjo pjesemarrje nuk eshte angazhuese per ne, por eshte e domosdoshme se pari si nje akt prezence i vendit tone ne kete forum dhe se dyti per te eksploruar mundesite konkrete te perfshirjes se Shqiperise ne bashkepunimin me NATO-n.

Lutemi mendimin tuaj.



Tirane, me 5 dhjetor 1991

NATO



OTAN

SERVICE DE PRESSE

PRESS SERVICE

NATO/OTAN, 1110 Brussels/Bruxelles • Tel.: 728 41 11 - Telex: 25-599  
Telefax/Télécopieurs: 728 50 57 - 728 50 58

PRESS COMMUNIQUE M-NACC-1(92)154

For immediate release  
5th June 1992

STATEMENT ISSUED AT THE MEETING OF THE  
NORTH ATLANTIC COOPERATION COUNCIL  
IN OSLO, NORWAY

5th June 1992

1. We, the Foreign Ministers and Representatives of the countries participating in the North Atlantic Cooperation Council have gathered in Oslo to consult on the major security issues, including regional conflicts as well as nuclear weapons issues, in the area stretching from Vancouver to Vladivostok and to deepen further our cooperation, building on our two previous meetings. We are pleased today to welcome Georgia as a member of this Council. We also welcome the membership of Albania in the North Atlantic Cooperation Council.

2. It is only six months since our first meeting but already the North Atlantic Cooperation Council has proved its value as a forum for closer cooperation and consultation among our countries, contributing to our own and to international security. We note with satisfaction the ongoing implementation of our Work Plan for Dialogue, Partnership and Cooperation. Regular meetings of cooperation partners with the North Atlantic Council and its subordinate bodies on security and related issues - including political, military, economic, scientific and environmental subjects - and exchanges on concrete problems such as defence conversion and civil/military coordination of air traffic management, enable us to pursue effective action to achieve our shared goals. Practical cooperation on defence matters is expanding. However, this represents only a beginning and much remains to be done. The experience gained will enable us to develop further our cooperation and to respond to specific needs of our countries.

3. Our Council contributes to the building of a new security architecture based on cooperative relations among states and a network of mutually reinforcing institutions. In support of the CSCE process and other institutions, we will work to

increase stability and confidence and to promote transparency. Frameworks of regional cooperation will also be important in enhancing the CSCE process. We reaffirm the importance of efforts to create modern, competitive market economies with a view to overcoming grave economic disparities and thus enhancing our common security and stability. We are striving to reduce armed forces and armaments to minimum levels consistent with legitimate security requirements and to ensure democratic control of armed forces.

4. The CSCE has a vital role to play in achieving a more peaceful and cooperative Europe. We are committed to working with all CSCE participating states to ensure that the Helsinki Summit opens a significant new chapter in the CSCE process. In this respect, we attach particular importance to enhancing the CSCE's operational and institutional capacity to contribute to conflict prevention, crisis management and the peaceful settlement of disputes, including peacekeeping, making use of the potential and support of CSCE countries and other organisations which are prepared to contribute. In this context, we have noted with interest yesterday's statement by Alliance Foreign Ministers in paragraph 11 regarding support for peacekeeping activities under the responsibility of the CSCE.

5. Regional conflicts and ethnic tensions have not yet been eliminated from the CSCE area. These are of direct concern to us and must be resolved by peaceful means in accordance with international law and principles embodied in the Helsinki Final Act, the Charter of Paris and other CSCE documents.

We deplore the continuing resort to force and resulting loss of life, as well as the suffering and extensive destruction in the territory of the former Yugoslavia, of which the tragedy in Bosnia-Herzegovina is yet another example. Although all parties to the conflict have contributed in their own way to the present state of affairs, the main responsibility falls on the authorities in the Federal Republic of Yugoslavia (Serbia and Montenegro) including the JNA. We express our strong support for the efforts of the UN, the CSCE and the European Community to end the hostilities and to find a negotiated solution to the crisis. We trust that Resolution 757 approved by the United Nations Security Council will convey the determination of the international community to pursue such objectives.

We are also profoundly disturbed by the escalation in the fighting, loss of life, suffering and extensive destruction in the crisis in Nagorno-Karabakh and beyond. We welcome the decision to convene the CSCE Conference in Minsk as well as all steps - such as the emergency preliminary meeting in Rome - designed to ensure its success, and the actions taken in the framework of the CSCE to bring about a peaceful solution to this

conflict. We will contribute towards this goal and urge all parties concerned to do likewise. We support efforts within the CSCE to agree arrangements for the timely introduction of civilian observers to the region to contribute to the peace process and we note the readiness of members of our Council to participate in such a mission.

We call on all parties involved in both cases immediately to establish effective ceasefires as fundamental contributions to the negotiation of peaceful solutions. We also call on all parties to facilitate the provision of urgently needed humanitarian assistance to the victims of both conflicts. We stress that any attempt through the use of force to acquire territory, change boundaries or achieve political ends is unacceptable and can only undermine efforts to achieve the lasting, negotiated and peaceful settlements which are essential.

6. Military forces should be stationed on the territory of a foreign state only with the consent of that state. We recognize the importance of establishing soon, in the negotiations underway, a timetable for the withdrawal of foreign troops from the Baltic states.

7. We are deeply concerned by the dangers of nuclear proliferation, including by diversion of nuclear materials, and we attach the greatest importance to the safety and security of nuclear weapons. In this context, we stress the vital role played by the Treaty on the Non-Proliferation of Nuclear Weapons (NPT) and the safeguards system of the International Atomic Energy Agency in preventing the further spread of such weapons and of nuclear-weapons technology and expertise. We therefore reiterate our unequivocal support for the Treaty and undertake to do everything we can to guarantee its integrity and further its objectives. We urge all states which have not yet acceded to it to do so as non-nuclear weapon states without delay and we call upon all states parties fully to abide by their obligations. With a view to reducing nuclear arsenals, we call for speedy ratification and entry into force of the START Treaty and implementation of other commitments to cut back, transfer and eliminate nuclear forces.

8. The consolidation and implementation of existing arms control, disarmament and confidence-building agreements, and the negotiation of new initiatives in the new CSCE Forum for Security Cooperation to be established within the CSCE, are fundamental to the cooperative security process. In support of these aims:

- we welcome agreement on the Final Document of the Extraordinary Conference which will provide the basis for the entry into force of the CFE Treaty, with all the new states within the CFE area of the former Soviet Union as full participants. We note with appreciation the contribution of the High Level

Working Group to this successful result. Those of us concerned reaffirm our determination to bring into force the Treaty by the time of the Helsinki Summit Meeting of the CSCE on July 9-10, 1992 and stress the necessity of states parties concerned taking the steps necessary as soon as possible in order to meet this target date;

- we support the determination of the participants in the CFEIA negotiations to reach an agreement to limit the personnel strength of their conventional armed forces in time for the Helsinki Summit;
- we emphasize the importance of prompt and full implementation of the provisions of the Vienna 1992 Document on confidence and security building measures by all CSCE states; it will strengthen stability and promote transparency within the CSCE area;
- we look forward to the early entry into force of the Treaty on Open Skies and adherence to it by interested states which are participating in the CSCE but are not original signatories to the Treaty as provided for by Article XVII of the Treaty and called for in the CSCE Open Skies Declaration of 24th March 1992;
- we urge all states to exercise restraint and responsibility in the field of conventional arms transfers and call on all to submit full relevant data to the UN Register of Arms Transfers.

9. The eradication of chemical weapons is a challenge for all nations. We urge the conclusion this year and early entry into force of a global, comprehensive and effectively verifiable ban on chemical weapons.

10. Finland attended this meeting as an observer at its request.

11. We look forward to the next meeting of the North Atlantic Cooperation Council in Brussels in December 1992.

12. We express our deep appreciation for the gracious hospitality extended to us by the Kingdom of Norway.

U R G E N T

323

A M B A S A D E S      P R A G E

( Per zotin Ilir BOÇKA )

Zoti Petraq Pojani nga Brukseli,njofton se zevndes sekretari i Pergjitheshem i NATO-s,ambasadori MOLTKE,e kish njoftuar ate se eshte i gateshem qe te takohet me Ministrin Shqiptar te Puneve te Jashtme,ne mbledhjen e KSBE-se ne Prague.

Per sa siper,delegacioni yne duhet te marre kontakte qe diten e pare te mbledhjes,per te rene dakord per kohen e takimit.

Tirane,me 29.1.1992

MINJASHTME



Lajme për Shqipërinë )

Kutimet e vegjelisë së Besnikut janë shqetësimet që i sillnin fëmijët në fshat për shkak të të atit të tij "kriminel". "Dikur ne ishim të pasur dhe në krye të shkallës", rënkon ai. "Tani ne jemi më të fundit e të fundit".-R.Xh.LT./ATSH/

**SHQIPERIA DO TA INTEGROJË USHTRINË E SAJ ME  
NATO-n**

**OHËR, 3 shkurt/TANJUG/- Shqipëria shprehu sot zyrtarisht dëshirën e vet për "integrin në strukturat e NATO-s" të ushtrisë së vet. Dëshira u shpreh nga gjenerali Kristaq Karoli, shefi i shtabit të ushtrisë shqiptare, gjatë një takimi me gjeneralin amerikan Xhon Xhamber, kryetar i një delegacioni amerikar që është duke vizituat këto ditë forcat e armasotura të Shqipërisë.**

"Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme, lind nevoja për bashkëpunim me ushtritë e tjera, veçanërisht me ushtrinë amerikane, në mënyrë që të arrihet niveli që kërkohet tani", i tha mikut të vet gjenerali Karoli.

Sipas një njoftimi të dëgjuar në qytetin Ohër, në Jugosllavinë Juglindore, gjenerali Xhamber u prit nga presidenti i Shqipërisë, Ramiz Alia. Duke shprehur kënaqësinë për vizitën e një delegacioni ushtarake amerikan të nivelit të lartë për herë të parë që prej Luftës së Dytë Botërore, Alia e vlerësoi atë si "hapj e e rrugës së bashkëpunimit në fushën ushtarake dhe në interes të pagues e të qëndrueshmërisë".

Gjenerali Xhamber e delegacioni i tij u priten gjithashu në Tiranë nga ministri i Morojtjes Alfred Moisiu dhe nga shefi i diplomacisë Ilir Bocka. Delegacioni vizitoi gjithashu një njësi ushtarake shqiptare në Lezhë.-Dh.Ça.LT./ATSH/

-----  
N/ la,

1433


MISIONIT BRUKSEL  
Z. Petraq Pojani

10

Tuajit nr.50

Ne takimin me Moltken theksoni se ne vijim te bisedes qe pati ministri me te ne Prage, synimi i pales sone eshte qe, nepermjet kontakteve jo-zyrtare, te shikohet mundesia e bashkepunimi ne te ardhmen e afert. Moltke na shpjegoi proceduren per vendosjen e kontakteve me NATO-n dhe ne jemi ne pritje te perqjigjes se tij. Ju mos e nxitni, por shprehni qatishmerine per te vazhduar kontaktet jo-zyrtare. Mbani shenim cfare do te thote ai.

MINJASHTME



Tirane, me 5 shkurt 1992

12

Faks nr 66

KONTAKUAR SE PUSHPYL TE SHQIPERISE

(Drejtoren se USHON.)

1. I bërtë vizita gjedhjeve të parashikshon te NATO-s, Njëkoh, Duke i referuar bisodave me Punge me qindarën e llojeve te jashtme te Shqipërisë, tha se interesim i saj është të shtrojnë në një nga mbledhjet e afrota te Keshillit. Mendimet për bashkëpunimin e NATO-s me vendet të tjera janë të ndryshme edhe përcia NATO-s. Sidogjofte vete procesi i bashkëpunimit do të jetë i gjate. Ndhe ne juan të interesar per bashkëpunimin me Shqipërinë, vashndë si, aq ne tjerë ne kontekstin e zhvillimeve te jugosllavë.

2. Ambasadori turk iu zo, Onçori, me thasho qëshujen e perfshirjes se Shqipëri është grapi i vendevë me të cilat NATO po vendos lidhje bashkëpunimi, o ka shtruar ne mbledhjen e fundit te Keshillit Turqisë dhe Italisë. Francë ne përgjithësi oshtë e reservuar per zgjerimin e këtij raste bashkëpunimit, sepse nuk dehiron që NATO te mbuloje plotësish aspektin e sigurimit që te nivojtja ne KSHE. Prandaj, behen paripjekje per të rritur peshen e Bashkimit Evropian Perëndimor.

Bruksel, me 11 shkurt 1992

Petraq, Pojani



Z. S. Berisha 13  
Z. V. Ahmeti

Shenim:

Nga përfaqesia jone ne Bruksel njoftohemi se lidhur me letren e kryeministrit Vilson Ahmeti drejtuar Sekretarit te Përgjithshem te NATO-s, zevendessekretari i përgjithshem i kesaj organizate ambasadori Moltke tha se me 10 prill 1992 mbledhen shefat e Shtabeve te Këshillit Koordinues te NATO-s dhe se eshte e pamundur qe Shqiperia te marre pjese ne kete mbledhje.

Sipas perfaqesise sone ne Bruksel , sekretari i përgjithshem i NATO-s eshte i gatshem te prese ne nje takim Ministrin e Puneve te Jashtme te Shqiperise ne maj ose qershori te ketij viti. Duke patur parasysh se me 11 maj 1992 parashikohet te nënshkruhet ne Bruksel Marreveshja e tregtise dhe e Bashkëpunimit Ekonomik midis KE dhe Shqiperise, përfaqesia jone eshte e mendimit qe nënshkrimi te behet nga kryeministri i Shqiperise Ky rast te shfrytezohet edhe per nje kontakt me NATO-n. Për kete eshte e nevojshme qe me krijimin e qeverise perfaqesia ne fjale te rjoftohet sa me pare per te bere propozimet dhe per te organizuar kontaktet e nevojshme.

Tirane, me 10 prill 1992



05 JUN 1992 10:00

NATO DIV POL AFF

027280220 P.02/02

NR. 9000000222 8.

18

ORGANISATION DU TRAITÉ  
DU ATLANTIQUE NORD



NORTH ATLANTIC  
TREATY ORGANIZATION

LE SECRÉTAIRE GÉNÉRAL  
SECRETARY GENERAL

SG/92/417

OBSTON

OBSTON

7. 6. 92

MM

H.E. Aleksander Meksi  
Prime Minister  
Council of Ministers  
Republic of Albania  
Tirana  
Albania

Your Excellency,

In response to your letter of April 24th requesting Albania's membership in the North Atlantic Cooperation Council, I am pleased to advise you that the NACC meeting in Oslo, June 5th, agreed to welcome your membership on the basis of Albania's agreement to associate itself with the NACC statements of December 20, 1991 and March 10, 1992 and that issued by the June 5th meeting.

The text of the June 5th Statement which reflects this decision in paragraph 1 is enclosed. I look forward to your confirmation that Albania can associate itself with this statement.

May I express my personal satisfaction with the decision to include Albania in the NACC and warmly welcome your membership. I look forward with pleasure to your representatives joining in NACC activities.

Respectfully,

Manfred Woerner



□

□

TOTAL P.02

REPUBLIC OF ALBANIA  
COUNCIL OF MINISTERS  
Prime Minister

Tirana, 30.06.1992

Excellency,

I have the honour to acknowledge the receipt of your letter of June 5 th, 1992 informing me that the North Atlantic Cooperation Council(NACC) in its recent meeting in OSLO agreed to admit the Republic of Albania as a member to this Council.

I would like to thank NACC member countries and you personally for the efforts and goodunderstanding, which enabled my country to establish contacts and start afruitful cooperation with NACC.

On behalf of the Albanian Government, I would like to fully endorse and express the agreement for the text of the Statement of the OSLO Meeting of the 5 th of June,which you so kindly attached to your letter. Albania looks forward with great interest to join the future activities of NACC and to strengthen its cooperation with member countries.

With the highest considerations,

Sincerely yours



Aleksander Meksi

H.E. Manfred Woerner  
SECRETARY GENERAL  
NORTH ATLANTIC TREATY  
ORGANISATION  
B R U X E L L E S